



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS KLINË

Numri i lëndës: 2021:231840

Datë: 05.02.2024

Numri i dokumentit: 05286729

C.nr. 698/21

Gjykata Themelore Pejë-Dega në Klinë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtaren Fllanza Hashani, me bashkëpunëtoresh profesionale Albulena Morina-Lulaj, në çështjen juridike kontestimore të paditësit: V. (S.) R., nga fshati S... , Komuna e Klinës, të cilin e përfaqëson i autorizuari Xh. M. , avokat në K... , kundër të paditurve: Ndërmarrja e R...-T... B... S... SH.P.K, nga K... dhe S. (R.) H. , nga fshati A...., Komuna e Skenderaj, Rr.’’ ...’’, pn. me bazë juridike: prishje e kontratës dhe vërtetim i pronësisë, vlera e kontestit: 3,500.00€, jashtë seancës gjyqësore me datë 02.02.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

I.KONSIDEROHET E TERHEQUR padia e datës 15.10.2021, me shenjën C.nr. 698/21, e paditësit V. (S.) R. , kundër të paditurve: Ndërmarrja e R...-T... B... S... SH.P.K dhe S. (R.) H. , me bazë juridike: prishje e kontratës dhe vërtetim i pronësisë, vlera e kontestit: 3,500.00€.

II. Secila palë bart shpenzimet e veta procedurale

A r s y e t i m

Paditësi përmes të autorizuarit të tij me datë 15.10.2021, ka parashtruar padi kundër të paditurve: Ndërmarrja e R...-T... B... S... SH.P.K dhe S. (R.) H. , me bazë juridike: prishje e kontratës dhe vërtetim i pronësisë, vlera e kontestit: 3,500.00€.

Gjykata në këtë çështje juridike kontestimore ka caktuar shqyrtimin përgatitor me datë 25.01.2024, me fillim në ora 09:05, në të cilën nuk ka prezantuar i autorizuari i paditësit, i cili ka qenë i ftuar në mënyrë të rregullt nga gjykata, që është vërtetuar nga flet kthesa në shkresat e lëndës, nga e cila rezulton se i autorizuari e ka pranuar ftesën me datë 21.12.2023, por i cili

mungesën e tij nuk e ka arsyetuar. Gjithashtu në seancë nuk ka prezantuar as i padituri i dytë S. H. , i cili është ftuar në mënyrë të rregullt po mungesën nuk e ka arsyetuar, ndërsa përfaqësuesi i të paditurës së parë Ndërmarrja e R...-T... B... A. H. ka qenë prezent dhe i ka propozuar gjykatës pasi që paditësi është ftuar në mënyrë të rregullt dhe nuk e ka arsyetuar mos ardhjen e tij padinë ta konsideroj të tërhequr.

Sipas nenit 409 par. 1 të Ligjit Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore (LPK), përcaktohet se *‘Në qoftë se në seancën përgatitore nuk vjen pala paditëse edhe pse është thirrur rregullisht, padia konsiderohet e tërhequr, përveç kur i padituri kërkon që seanca të mbahet në mungesë të paditësit’*. Prandaj në referim të kësaj dispozite ligjore dhe nga arsyet e lartcekura rezulton se plotësohen të gjitha kushtet ligjore që padia në këtë çështje kontestimore, të konsiderohet e tërhequr.

Andaj, gjykata duke u mbështetur në dispozitat e nenit 409 par. 1 lidhur me nenin 387 par. 1 pika c dhe nenit 450 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË-DEGA NË KLINË-

Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil

C.nr.698/21, data 02.02.2024.

Gj y q t a r j a:

Fllanza Hashani

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktvendimi, nëpërmes kësaj Gjykate për Gjykatën e Apelit